



№. 35 prot
Shkodër 20/06/18

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË



V E N D I M

Nr. 1 Datë 13. 06. 2018

“ PËR RINOVIM TË LEJES PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR”

SUBJEKTIT “NORDIN 1” SH.P.K.

Në mbështetje të ligjit nr.6/2018 për disa ndryshime dhe shtesa të ligjit nr.111/2012 dt.15.12.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të nenit 38 “Qëllimet e përdorimit të burimeve ujore” gërma b, dhe të nenit 41 “Përdorimi me leje i ujit” gërma a dhe ë; të VKM Nr.416 datë 13.05.2015, “Për miratimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje për përdorim të burimeve ujore”, bazuar në relacionin e paraqitur nga A.B.U. Drin-Bunë, miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe oponencës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin-Bunë,

V E N D O S I :

1-Të miratojë kërkesën e subjektit “**NORDIN 1**” SHPK me administrator z. Beqir ZENELI, me vendodhje në fshatin Spathar, Njësia Administrative Vau Dejës, Bashkia Vau Dejës, Qarku Shkodër për rinovim të lejes për përdorim të burimit ujqor **kanal vaditës** (Spathar-Juban-Guri i Zi), për Akuakulturë.

Vepra e marrjes ka këto koordinata: X – 46 53 575; Y – 43 84 000; Z – + 22 m;

Pika e shkarkimit ka këto koordinata : X – 46 53 638; Y – 43 83 829; Z – + 16 m;

Prurja mesatare vjetore e burimit është: $Q_{mes} = 0.02 \text{ m}^3/\text{sek}.$

Prurja mesatare e muajit më të thatë është: $Q_{mes1} = 0.02 \text{ m}^3/\text{sek}.$

Sasia e ujit që jepet për përdorim është: $Q_{llog} = 0.02 \text{ m}^3/\text{sek} (20 \text{ l/sek}).$


2-Leja e përdorimit të burimit ujqor jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zonë dh e rezerva e domosdoshme ekologjike.

3-Ngarkohet A.B.U. Drin- Bunë për ndjekjen e procedurave përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

SEKRETAR

Raimonda GURI



KRYETAR

Cesk MILLJA

